



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESOR PRIVAT
ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT « ENFORCEMENT GROUP » SHPK

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla Nr.1, Pall. e Shoqërisë "GORA" Kati 3, Ap.14, Tirane / Cel. 0692087566
e-mail : enforcementgroup2014@gmail.com

Nr. 39/8 Prot.
Nr. 1905 Regj

Tirane me, 08.03.2021

**URDHËR
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE
MBI KUOTAT E DEBITORIT**

Drejtuar : Qendres Kombetare te Biznesit/Tiranë
Per dijeni: Debitorit Shoqëria KST ADVERTISING shpk me Nipt L51406504H
Adresa: Lagjja 14, Rruga Haziz Shkupi, Shkozë, Durrës
Për dijeni: Kreditorit Shoqëria Elim Agron shpk Nipt K81519014I
Adresa: Rruga Elbasanit, Hotel Arandë, 200 m poshte stacionit te fundit te Saukut, Farkë e Vogël, Tiranë



Unë Altin Latifi me detyrë Përmbarues Gjyqësor Privat pranë Zyrës Përmbarimore Private "Enforcement Group" shpk, pasi studiova materialet e dosjes me Nr.1905 Regj, bazuar në titullin ekzekutiv Faturë tatimore me numër serie 87324479 datë 04.12.2020 me vlerën 14,000 (katërmëdhjetë mijë) Euro lëshuar nga shitësi Shoqëria Elim Agron shpk Nipt K81519014I për blerësin shoqëria KST ADVERTISING shpk me Nipt L51406504H,

KONSTATOVA

Se pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Enforcement Group" shpk, është depozituar për Ekzekutim, kërkesa e kreditorit Shoqëria Elim Agron shpk Nipt K81519014I, së bashku me Titullin Ekzekutiv Faturë tatimore me numër serie 87324479 datë 04.12.2020 me vlerën 14,000 (katërmëdhjetë mijë) Euro lëshuar nga shitësi Shoqëria Elim Agron shpk Nipt K81519014I për blerësin shoqëria KST ADVERTISING shpk me Nipt L51406504H, për të cilën ka dalë Urdhri i ekzekutimit Vendimi Nr. 308 datë 10.02.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me pale e objekt:

Kreditor: Shoqëria Elim Agron shpk Nipt K81519014I
Debitor: Shoqëria KST ADVERTISING shpk me Nipt L51406504H
Objekti: Pagim shume

Me anë të këtij Urdhri ekzekutimi është vendosur:

1-Lëshimi i Urdhrit të ekzekutimit për Titullin Ekzekutiv Faturë tatimore me numër serie 87324479 datë 04.12.2020 me vlerën 14,000 (katërmëdhjetë mijë) Euro lëshuar nga shitësi Shoqëria Elim Agron shpk Nipt K81519014I për blerësin shoqëria KST ADVERTISING shpk me Nipt L51406504H.
2-Llogaritjen e kamatave ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi Ligji Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare."

Në kushtet kur debitori nuk e shleu vullnetarisht detyrimin atëherë nga ana jonë në bazë të nenit 519 K.P.Civile kemi vijuar me procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm duke vendosur sekuestro mbi pasuritë e palës debitore.

Për rrjedhojë me qëllim vijimin e procedurave përmbarimore dhe ekzekutimin e Urdhrit të ekzekutimit të sipërcituar duhet vijuar me vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe kuotat e debitorit.

Vlera e detyrimit të derdhet në llogarinë bankare të vecantë të përmbaruesit pranë BKT sha me emertimin Zyra e Përmbarimit Privat Enforcement Group shpk – Altin Latifi Llogari Përmbaruesi e Vecante me numër llogarie 425786282CLPRBLALLAC dhe IBAN: AL2120511258786282CLPRBLALLA.

Për sa më sipër: Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHËROJ:

1. **Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi kuotat e Shoqëria KST ADVERTISING shpk me Nipt L51406504H me seli në Lagjja 14, Rruga Haziz Shkupi, Shkozë, Durrës.**
2. Kuotat e mesiperme do të qëndrojnë të sekuestruara deri në një urdher të dytë nga ana e zyres sone përmbartimore.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në nenin 606 të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkojë penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
5. Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.
6. Pas dergesës së këtij urdhëri për vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet e debitorit të sipërcituar në shoqëritë e sipërcituara, kërkojmë të na dërgohet pranë zyres sone statusi i aksioneve pas kryerjes së bllokimit, brenda afatit ligjor.

ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT "ENFORCEMENT GROUP" SHPK

PËRMBARUESI GJYQËSOR

ALTIN LATIFI

Vlera e detyrimit të derdhet në llogarinë bankare të vecantë të përmbartuesit pranë BKT shp me emërtimin Zyra e Përmbartimit Privat Enforcement Group shpk – Altin Latifi Llogari Përmbartuesi e Vecante me numër llogarie 425786282CLPRBLALLAC dhe IBAN: AL2120511258786282CLPRBLALLA.